



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5779 Prot.

Lezhë, më 01 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 59 Datë 30 . 03 .2021

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NR.172
DATË 27.11.2020 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2021 DHE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023”**

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , neni 8, pika 2, neni 54 gërma ç, dhe “dh”, ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.172, datë 27.11.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtesë në pikën 3, “Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Lezhë dhe institucioneve të varësisë 2021, të Vkb-së Nr.172 datë 27.11.2020 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2021 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023” konkretisht si më poshtë:
 - 1.1 Shtohet numri i punonjësve me kontratë në programin buxhetor si më poshtë:
 - Në programin buxhetor “10140” “Kujdesi Social (PAK)” shtohen 5 punonjës me kontratë sipas afatit të zbatimit të projektit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

